



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 79, datë 23.12.2025



PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË ZONAVE PRIORITARE TË ZHVILLIMIT NË TERRITORIN E BASHKISË Durrës NË PËRPUTHJE ME PARASHIKIMET E LIGJIT NR. 20/2025, "PËR PAKETËN E MALEVE" DHE UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË PUSHTETIT VENDOR NR. 2, DATË 15.10.2025

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 20/2025, "Për paketën e maleve", ligjit nr. 93/2015 "Për turizmin", ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i përditësuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" e përditësuar, Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 2, datë 15.10.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive", Urdhërit të kryetarit të bashkisë me Nr. 433, datë 27.11.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për identifikimin dhe hartëzimin e zonës së zhvillimit brenda territorit të bashkisë Durrës, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 20/2025, "Për paketën e maleve" dhe Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 2, datë 15.10.2025", si dhe sipas relacionit të hartuar nga grupi i punës ngritur me urdhërin e sipërcituar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të Zonave Prioritare të Zhvillimit në bashkinë Durrës, Njësitë Administrative Ishëm, Rrashbull dhe Manëz, në zbatim të ligjit nr. 20/2025, "Për paketën e maleve" dhe Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 2, datë 15.10.2025 "Për

përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive”, si më poshtë vijon:

- a. Njësia Administrative Ishëm, fshatrat: Gjuricaj, Kapedanaj, Kërtushaj, Likmetaj, Kuratën, Lalëz, Bizë, Daraç, Shetaj.
 - b. Njësia Administrative Rrashbull, fshatrat: Rrashbull, Arapaj, Xhafzotaj, Shënavlash, Shkallnur, Romanat, Bozanxhije, Maskuri.
 - c. Njësia Administrative Manëz, fshatrat: Manëz Armath, Borç, Hamallaj, Kameras, Radë, Shkallë, Fshat Manëz.
2. Pas përfundimit të procedurës së sipërcituar, të përcillet i gjithë dokumentacioni përkatës pranë Ministrisë së Pushtetit Vendor për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Terroitorit pranë Bashkisë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.


KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 24.12.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 906 prot.

Durrës, më 05 01 .2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.79 datë 23.12.2025 “Për miratimin paraprak të zonave prioritare të zhvillimit në territorin e Bashkisë Durrës në përputhje me parashikimet e ligjit nr 20/2025, “Për paketën e maleve” dhe udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr 2 dt 15.10.2025 ”

Bazuar në Ligjin nr 20/2025 “Për paketën e maleve” dhe Udhëzimin nr 2 dt 15.10.2025 “ Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e Bashkive” i cili shfuqizon Udhëzimin nr 1 dt 19.06.2025 të ministrit të shtetit për Pushtetin vendor “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territorin e bashkive”. (Kreut III /1 i këtij udhëzimi), përcaktohet se pas përfundimit të procedurës të parashikuar në kreun II , është ***Kryetari i Bashkisë ai që paraqet pranë ministrit përgjegjës për pushtetin vendor kërkesën për shpalljen e zonës zhvillimore në territorin e Bashkisë.***

Si rrjedhojë sipas legjislacionit në fuqi vendimmarrja e Këshillit Bashkiak është jashtë kompetencave të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

